



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

STRUKTURA E ORGANEVE KOLEGJIALE AKADEMIKE NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË

1. SENATI AKADEMIK:

Senati Akademik është organi kolegjal më i lartë akademik i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë dhe kryesohet nga Rektori.

Anëtarët e Senatit Akademik, përfaqësues të personelit akademik, zgjidhen me shumicë votash, nga asambljetë e personelit akademik të njësive kryesore përkatëse, përmes një votimi të përgjithshëm. Ata zgjidhen për një mandat katërvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje, midis anëtarëve të personelit akademik me kohë të plotë, të vetëkandiduar.

Anëtarët e Senatit Akademik, përfaqësues të studentëve, zgjidhen nga studentët e UMT-së me shumicë votash. Mund të jenë përfaqësues të studentëve vetëm ata shtetas që janë studentë në UMT-së në çastin e zgjedhjes së tyre, për aq kohë sa gëzojnë statusin e studentit.

Bashkëlidhur Vendimi nr. 71, datë 09.09.2020 i Senatit akademik të UMT-së “Për konstituimin e Senatit Akademik të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”.

2. REKTORATI:

Rektorati është organ kolegjal në UMT, që drejtohet nga rektori dhe përbëhet nga rektori, zëvendësrektorët, drejtuesit e njësive kryesore dhe administratori i UMT-së.

Në mbledhjet e Rektoratit, sipas nevojës, mund të ftohen edhe funksionarë të tjerë të universitetit dhe/apo të njësive të tjera.

3. BORDI I ADMINISTRIMIT:

Bordi i Administrimit është organ kolegjal vendimmarrës, që mbikëqyr dhe kontrollon veprimtaritë e UMT-së në aspektet administrative, financiare dhe ekonomike, si dhe në ushtrimin e mbrojtjes së të drejtave të pronësisë publike të UMT-së.

Bordi i Administrimit përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë, të punësuar me kohë të pjesshme, nga të cilët 4 (katër) anëtarë janë përfaqësues të MAS dhe 3 (tre) anëtarë përfaqësues të UMT-së.

Anëtarët, përfaqësues të UMT-së, zgjidhen nga Senati Akademik për një mandat 5 (pesë) vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje, prej listës së anëtarëve të personelit akademik efektiv që vetëkandidojnë.

Bashkëlidhur Vendimi nr. 64, datë 22.11.2021 i Bordit të Administrimit të UMT-së “Për konstituimin e Bordit të Administrimit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”, Vendimin nr. 65, datë 22.11.2021 “Për zgjedhjen e Kryetarit të Bordit të Administrimit të UMT-së”.



4. ASAMBLEJA E PERSONELIT AKADEMIK:

Asambleja e personelit akademik përbëhet nga personeli akademik me kohë të plotë i 3 (tre) njësive kryesore të UMT-së .

5. KOMISIONET E PËRHERSHME:

Komisionet e përhershme janë organe kolegjiale të krijuara në nivel institucional, të cilat mbulojnë fusha të përcaktuara në Statutin e UMT-së. Përbërja e komisioneve të përhershme përcaktohet nga Senati Akademik.

Senati Akademik ngre komisionet e përhershme, të cilat përbëhen nga jo më pak se 5 (pesë) anëtarë, të cilët vetëkandidohen dhe zgjidhen nga Senati Akademik, për një mandat 2 (dy) vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje, si më poshtë:

- a. **Komisioni i Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik** - Komisioni i Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik në UMT përbëhet nga 15 (pesëmbëdhjetë) anëtarë. Anëtarët e këtij komisioni janë personel akademik me kohë të plotë i njësive kryesore të UMT-së, të cilët mbajnë titullin “Profesor”. Ata vetëkandidohen dhe përzgjidhen nga Senati Akademik i UMT-së. (bashkëlidhur Vendimi i KPPPA nr. 20, datë 03.03.2022 “Për konstituimin e Komisionit të Përhershëm të Promovimit të Personelit Akademik në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”).
- b. **Komisioni i Marrëdhënieve me Studentët** - Komisioni përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, nga të cilët 3 (tre) anëtarë janë pjesë e personelit akademik dhe 2 (dy) anëtarë përfaqësues të studentëve të ekselencës që do të zgjidhen nga Këshilli Studentor i UMT-së.

Anëtarët e komisioneve të përhershme të njësive kryesore në UMT, vetëkandidohen dhe zgjidhen nga asambleja e personelit akademik të njësisë kryesore midis anëtarëve të saj, për një mandat 2 (dy) vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.

- a. **Komisioni i Përhershëm për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor”** - Komisioni i Përhershëm për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor” ngrihet në nivel njësie kryesore. Anëtarët e këtij komisioni janë personel akademik me kohë të plotë i njësisë kryesore përkatëse. Ata vetëkandidohen dhe përzgjidhen nga asambleja e personelit akademik të fakultetit. Komisioni i Fakultetit të Mjekësisë përbëhet nga 11 (njëmbëdhjetë) anëtarë. Komisioni i Fakultetit të Mjekësisë Dentare përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë dhe Komisioni i Fakultetit të Shkencave Mjekesore Teknike përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë.

6. KËSHILLI I ETIKËS:

Këshilli i Etikës është organ kolegjial në UMT, i cili ka në përbërjen e tij 5 (pesë) anëtarë, personel akademik me kohë të plotë (ku çdo fakultet ka të paktën 1 (një) përfaqësues, të cilët i



propozohen rektorit nga drejtuesi i njësisë kryesore përkatëse dhe miratohen nga Senati Akademik).

Bashkëlidhur Vendimi nr. 32, datë 17.03.2020 i Këshillit të Etikës së UMT “Për miratimin e Këshillit të Etikës në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”.

7. KËSHILLI I BOTIMEVE:

Këshilli i Botimeve shkencore në UMT është një organ kolegjal, i cili ka në përbërje 7 (shtatë) anëtarë, personel akademik me kohë të plotë të kategorisë “Profesor”, nga të cilët minimumi një (1) anëtar të jetë nga Fakulteti i Mjekësisë, minimumi (1) një anëtar nga Fakulteti i Mjekësisë Dentare dhe minimumi 1 (një) anëtar nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike. Numri i anëtarëve me titullin “Profesor i asociuar” nuk mund të jetë më i madh se 2 (dy).

Bashkëlidhur Vendimi nr. 16, datë 10.03.2023 i Senatit Akademik të UMT-së “Për miratimin e Këshillit të Botimeve në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”.

8. DEKANATI:

Dekanati është organ kolegjal i fakultetit, që drejtohet nga dekani dhe përbëhet nga dekani, zëvendësdekanët, administratori i njësisë kryesore dhe drejtuesit e njësive bazë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
SENATI AKADEMIK

Nr. 2297/3 Prot.

Tiranë, më 10 / 09 / 2024

VENDIM

Nr. 104, datë 10 . 09 . 2024

PËR

“KONSTITUIMIN E SENATIT AKADEMIK
TË UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË, TIRANË”

Mbështetur në nenet 36, pika 7, 37, 38, 39, pika 4, të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; në nenet 24, 25 dhe 47 të Statutit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë; në nenin 4 dhe nenin 41 të Rregullores së Zgjedhjeve, miratuar nga Senati Akademik i UMT-së me Vendimin nr. 36, datë 29.03.2024, “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet, organet drejtuese dhe komisionet e përhershme, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”, e ndryshuar, si dhe në Vendimin e KIZ të UMT-së, nr. 23, datë 08.07.2024, “Për shpalljen e rezultatit të zgjedhjeve për anëtarë të Senatit Akademik të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”, Senati Akademik i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, në mbledhjen e datës 10.09.2024,

VENDOSI:

I. Të konstituojë Senatin Akademik të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, me përbërje si më poshtë:

A. KRYETAR

Xheladin DRAÇINI

B. Përfaqësues të Fakultetit të Mjekësisë

1. Arvin Dibra
2. Margarita Gjata
3. Alban Dibra
4. Krenar Lilaj
5. Elizana Zaimi (Petrela)
6. Sokol Xhepa
7. Ilir Alimehmeti
8. Arsen Seferi
9. Leart Berdica

10. Florian Toti
11. Altin Veshti
12. Alma Idrizi

C. Përfaqësues të Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike

1. Irena Kola
2. Alma Nurçe
3. Gentian Stroni
4. Ergys Ramosaçaj

D. Përfaqësues të Fakultetit të Mjekësisë Dentare

1. Silvana Bara
2. Edit Xhajanka

E. Përfaqësues të studentëve

1. Klea Veli
2. Armelda Ago

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.

KRYETARI

PROF. DR. XHELADIN DRAÇINI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 3042 / Prot.
1

Tiranë, më 22, 11, 2021

VENDIM

Nr. 64, Datë 22.11.2021

“PËR KONSTITUIMIN E BORDIT TË ADMINISTRIMIT TË UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË, TIRANË”

Bazuar në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 36, pika 3; neni 47, neni 48 e vijues, në Vendimin e Senatit Akademik të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, nr. 74, datë 13.10.2021 “Për zgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë” si dhe në Urdhërin nr. 450, datë 16.11.2021 e Ministrisë të Arsimit dhe Sportit “Për lirimin nga detyra të anëtarëve të Bordit të Administrimit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë dhe emërimin në detyrë të anëtarëve të rinj, përfaqësues të Ministrisë Përgjegjëse për Arsimin”, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 22.11.2021,

VENDOSI:

1. Të konstitujë Bordin e Administrimit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, me përbërje si më poshtë:
 - Monika FIDA;
 - Vera OSTRENI;
 - Altina XHAFFERI;
 - Albana GJINOPULLI;
 - Anis THODHORJANI;
 - Zamira GJINI;
 - Endrit YZEIRAJ.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe të publikohet në faqen zyrtare (web) të UMT-së.

Monika FIDA

Albana GJINOPULLI

Vera OSTRENI

Anis THODHORJANI

Altina XHAFFERI

Zamira GJINI

Endrit YZEIRAJ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 3042 / Prot.
2

Tiranë, më 22.11 .2021

VENDIM

Nr. 65, Datë 22.11.2021

**“PËR ZGJEDHJEN E KRYETARIT TË BORDIT TË ADMINISTRIMIT TË
UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË, TIRANË”**

Bazuar në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 36, pika 3; neni 47, neni 48 e vijues, në Vendimin e nr. 1, datë 22.11.2021 “Mbi konstituimin e Bordit të Administrimit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 22.11.2021,

VENDOSI:

1. Të zgjedhë me unanimitet Znj. **Zamira GJINI** si Kryetare e Bordit të Administrimit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë dhe znj. **Monika FIDA** si zv. Kryetare.
2. Ky vendim i përcillet për njohje Rektorit të UMT-së Prof. Dr. Arben GJATA, Administratorit të UMT-së z. Besnik ÇINA si dhe Njësitve Kryesore të UMT-së.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe të publikohet në faqen zyrtare (web) të UMT-së.

Zamira GJINI

Monika FIDA

Vera OSTRENI

Albana GJINOPULLI

Altina XHAFERI

Anis THODEHORJANI

Endrit YZEIRAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
SENATI AKADEMIK

Nr. 522 / prot.
2

Tiranë, më 23 .02.2024

VENDIM
Nr. 28 , datë 23 .02.2024

PËR
KRIJIMIN E KOMISIONIT TË PËRHERSHËM PËR PROMOVIMIN E PERSONELIT
AKADEMIK NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË

Në bazë të nenit 3, 38, 46 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 32, 33, 47 të Statutit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, të Vendimit të Senatit Akademik nr.56, datë 27.09.2019 “Për nisjen e procedurave për krijimin e Komisionit të Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”, të Vendimit të Senatit Akademik r.11, datë 26.01.2024 “Për fillimin e procedurave për përzgjedhjen e anëtareve të Komisionit të Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë dhe miratimin e kriterëve që duhet të plotësojnë kandidatët për anëtar në këtë komision”, të Vendimit të Senatit Akademik nr. 18, datë 16.02.2024 “Për ngritjen e komisionit me qëllim vlerësimin e dosjeve të kandidatëve për Komisionin e Përhershëm për Promovimin ...”, të Relacionit të komisionit të vlerësimit të Senatit Akademik, nr. 497 prot., datë 20.02.2024, pas diskutimeve të rendit të ditës dhe procesit të votimit për anëtarët e Komisionit të Përhershëm të Promovimit të Personelit Akademik në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, pasqyruar në Proces – Verbalin nr. ____ prot., datë 23.02.2024, Senati Akademik,

VENDOSI:


1. Të mosmiratojë si kandidate për anëtare Prof. Dr. Suzana Gjeci, për shkak të mbushjes së moshës së pensionit.
2. Të zgjedhë anëtarët e rinj të Komisionit të Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, nëpërmjet procesit të votimit, i përbërë nga 15 (pesëmbëdhjetë) anëtarë, si më poshtë:

| Nr. | Emër Mbiemër |
|-----|--------------|
| 1 | Arvin Dibra |
| 2 | Alma Idrizi |
| 3 | Alban Dibra |

| | |
|----|-------------------------|
| 4 | Floreta Kurti |
| 5 | Rudin Domi |
| 6 | Elizana Zaimi (Petrela) |
| 7 | Florian Toti |
| 8 | Ilirjana Zekja |
| 9 | Vera Ostreni (Halili) |
| 10 | Andi Koraqi |
| 11 | Merita Bardhoshi |
| 12 | Helidon Nina |
| 13 | Agron Dogjani |
| 14 | Vjollca Durro |
| 15 | Agron Ylli |

3. Renditja e anëtarëve sipas votave të fituara është sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.


KRYETARI
PROF. ARBEN GJATA



SHTOJCA NR. 1

Renditja e anëtarëve të KPPPA-së në UMT sipas votave të fituara

| Nr. | Emer Mbiemer | Nr. i votave të fituara |
|-----|-------------------------|-------------------------|
| 1 | Arvin Dibra | 18 |
| 2 | Alma Idrizi | 18 |
| 3 | Alban Dibra | 18 |
| 4 | Floreta Kurti | 17 |
| 5 | Rudin Domi | 17 |
| 6 | Elizana Zaimi (Petrela) | 17 |
| 7 | Florian Toti | 17 |
| 8 | Ilirjana Zekja | 17 |
| 9 | Vera Ostreni (Halili) | 17 |
| 10 | Andi Koraqi | 16 |
| 11 | Merita Bardhoshi | 14 |
| 12 | Helidon Nina | 14 |
| 13 | Agron Dogjani | 13 |
| 14 | Vjollca Durro | 12 |
| 15 | Agron Ylli | 12 |
| 16 | Gentiana Qirjako | 11 |





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
SENATI AKADEMIK

Nr. 930/prot.
5

Tiranë, më 29/03 /2024

VENDIM

Nr. 38, datë 29.03.2024

PËR

“MIRATIMIN E PËRBËRJES SË KËSHILLIT TË ETIKËS NË UNIVERSITETIN E
MJEKËSISË, TIRANË”

Në bazë të neneve 3, 36, pika 5, 44, e vijues ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; të nenit 26, pika 1, shkronja “m” dhe 37 e vijues të Statutit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë; të shkresës së Fakultetit të Mjekësisë me nr. 736/1 prot, datë 29.02.2024 “Në përgjigje të shkresës...” protokolluar me tonën nr. 571/1 prot., datë 29.02.2024; të shkresës së Fakultetit të Mjekësisë Dentare me nr. 135/1 prot, datë 11.03.2024 “Mbi përfaqësimin e Komisionit të Etikës ...”, protokolluar me tonën nr. 571/2 prot, datë 11.03.2024; të shkresës së Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike me nr. 266/1 prot., datë 19.03.2024 “Kthim përgjigje...”, protokolluar me tonën nr. 571/3 prot., datë 19.03.2024; të propozimit të Rektorit të UMT nr. 949 prot., datë 27.03.2024 “Dërgojmë propozimet për anëtarë të Këshillit të Etikës”, pas diskutimeve, Senati Akademik,

VENDOSI:

- I. Miratimin e Këshillit të Etikës në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, me përbërje si më poshtë:
 1. Adriana Babameto
 2. Dariel Thereska
 3. Zamira Ylli
 4. Vergjini Mulo
 5. Zamir Damani
- II. Vendimi i Senatit Akademik të UMT-së nr. 32, datë 17.03.2020 “Për miratimin e Këshillit të Etikës në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë” i ndryshuar, shfuqizohet.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të UMT-së.

KRYETARI
ARBEN GJATA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
SENATI AKADEMIK

Nr. 846 / Prot
2

Tiranë, më 10.05/2023

VENDIM
Nr. 16, datë 10.05.2023

PËR
“MIRATIMIN E E KËSHILLIT TË BOTIMEVE NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË,
TIRANË”

Në bazë të nenit 3, 38 e vijues ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 5, 24, 26 e vijues të Statutit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, të nenit 6, 22 e vijues të Rregullores së Universiteti të Mjekësisë, Tiranë si dhe propozimeve të njësive kryesore të UMT-së dhe Rektorit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, Senati Akademik pasi u njoh me emrat e propozuar për anëtarë të Këshillit të Botimeve në Universitetin e Mjekësisë Tiranë dhe duke mbajtur në konsideratë përfundimin e mandatit të anëtarëve aktual të këtij këshilli,

VENDOSI:

1. Të miratojë Këshillin e Botimeve në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, me përbërje të anëtarëve si më poshtë:
 - Prof. Suela Këlliçi
 - Prof. Xheladin Draçini
 - Prof. Ariel Çomo
 - Prof. Jovan Basho
 - Prof. Asoc. Enkelejda Sina
 - Prof. Gentian Vyshka
 - Prof. Ramazan Isufi
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi njësitë kryesore të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë dhe anëtarët e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
ARBEN GJATA

